



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 80/2021

PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre për organizata jofitimprurëse, të cilat kanë detyrimin për t'u regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të lehtësojë procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse duke krijuar një mjedis transparent dhe mundësues për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “Dokumente shoqëruese” janë dokumente të cilat provojnë të dhënat që regjistrohen.
2. “Kërkesë për regjistrim” është kërkesa që regjistrohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kryerjen e veprimeve në regjistër sipas këtij ligji.
3. “Kërkues” është organizata jofitimprurëse së cilës i përkasin të dhënat që regjistrohen, njoftohen ose depozitohen në regjistër, ose personat e tjerë që sipas këtij ligji kanë të drejtë të kërkojnë kryerjen e veprimeve në regjistër.
4. “Mjet elektronik” është çdo mjet me anë të të cilit mundësohet dërgimi fillestar i informacionit e marrja e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë ngjeshjen shifrore) dhe ruajtja e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella ose të marra përmes kablllove, valëve radio, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike.
5. “Organizata jofitimprurëse” ka të njëjtin kuptim si në ligjin që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse.
6. “Palë e tretë” është çdo person fizik ose juridik, ose mbajtës i interesave kolektive apo interesave të gjera të publikut, i cili nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, por që të drejtat ose interesat e tyre të ligjshme mund të preken nga rezultati i regjistrimit.
7. “Përfaqësues ligjor i organizatës jofitimprurëse” është personi fizik që ka vendbanimin në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili përfaqëson dhe përgjigjet për organizatën jofitimprurëse në raport me autoritetet shtetërore dhe palët e treta, si dhe për ruajtjen e çdo informacioni dhe dokumenti zyrtar deri në 10 (dhjetë) vjet nga data e çregjistrimit të organizatës jofitimprurëse.
8. “Regjistri elektronik” është regjistri i organizatave jofitimprurëse, që krijohet dhe administrohet si një bazë të dhënash shtetërore, në të cilin regjistrohen organizatat jofitimprurëse sipas këtij ligji.
9. “Regjistrim fillestar” është regjistrimi për herë të parë në regjistër.
10. “Regjistrim tjetër” është çdo ndryshim, shtesë ose fshirje të dhënash në regjistër.
11. “Regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë edhe transformimin, bashkimin, çregjistrimin e subjektit nga regjistri.
12. “Sporteli elektronik” është portali elektronik i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i aksesueshëm nëpërmjet portalit e-albania, ku mundësohet ofrimi i shërbimit për publikun në distancë, duke komunikuar drejtpërdrejt me sistemin qendror për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse nëpërmjet mjeteve elektronike.
13. “Të dhëna” janë faktet, aktet dhe informacionet që regjistrohen, njoftohen ose depozitohen në regjistër.
14. “Të dhëna parësore dhe dytësore” kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin për bazat e të dhënave shtetërore.

KREU II

REGJISTRI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

SEKSIONI I

REGJISTRI DHE EFEKTET E REGJISTRIMIT DHE TË PUBLIKIMIT

Neni 4

Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse

1. Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse është një bazë e të dhënave shtetërore, nëpërmjet së cilës grumbullohet informacioni i organizuar dhe i ruajtur në formë elektronike për organizatat jofitimprurëse, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhet përmes një sistemi kompjuterik. Informacioni përbëhet nga dosje të veçanta elektronike për çdo organizatë jofitimprurëse që regjistrohet sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse krijohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. Të gjitha të dhënat, kërkesat për regjistrim dhe dokumentet shoqëruese, pavarësisht nëse janë paraqitur në formë shkresore apo elektronike sipas këtij ligji, regjistrohen dhe ruhen në regjistër në formë elektronike.

3. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave, të njoftuara dhe të depozituara në regjistrin elektronik, kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj.

4. Pjesë përbërëse e regjistrit janë edhe dokumentet e depozituara në anekset e tij sipas këtij ligji.

Neni 5

Të dhënat që regjistrohen

1. Regjistri elektronik përmban të dhëna parësore dhe dytësore, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të organizatave jofitimprurëse, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera të parashikuara me ligj.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.

Neni 6

Mënyra e regjistrimit

1. Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër kryhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për regjistrim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkesa për regjistrim paraqitet në formë shkresore ose në formë elektronike, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton formularët e kërkesave për regjistrim, si dhe listën e dokumenteve shoqëruese për çdo regjistrim që kryhet në regjistër sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Marrja dijani për regjistrim dhe publikim

1. Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin elektronik sipas dispozitave të këtij ligji, prezumohet se i është njoftuar çdo pale të tretë nga dita e publikimit sipas nenit 38 të këtij ligji. Pavarësisht këtij parashikimi, prezumohet që pala e tretë nuk është njoftuar për të dhënat e regjistruara dhe të publikuara në regjistër nëse brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e publikimit provon se e ka pasur të pamundur që të merrte dijani.

2. Kur të dhënat janë regjistruar ose publikuar në mënyrë të pasaktë në regjistrin elektronik, prezumohet që këto të dhëna nuk u janë njoftuar palëve të treta. Pavarësisht këtij parashikimi, prezumohet që pala e tretë është njoftuar nëse provohet se ajo ka pasur dijani për pasaktësinë e të dhënave të regjistruara ose të publikuara.

3. Të dhënat e regjistruara e të publikuara në regjistër, edhe nëse janë të pasakta, nuk dëmtojnë personat e tretë, të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tyre, përveç rasteve kur organizata provon se pala e tretë kishte dijani për pasaktësinë e të dhënave të publikuara ose për të dhëna të tjera të papublikuara.

4. Pala e tretë mund t'i kundrejtojë organizatës të dhëna ende të papublikuara kur, pavarësisht mospublikimit, kishte dijani për këto të dhëna, me përjashtim të rastit kur sipas ligjit mospublikimi nuk sjell pasoja.

5. Të dhënat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse vlerësohen gjithnjë të njohura dhe përbëjnë akt zyrtar për autoritetet publike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

SEKSIONI II

DETYRIMI PËR REGJISTRIM, RREGULLAT E EMËRIMIT, PERSONAT E AUTORIZUAR DHE FORMA E AKTEVE SHOQËRUESE

Neni 8

Detyrimi për regjistrim

Organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë detyrimin për t'u regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, janë të detyruara të paraqesin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për regjistrim fillestar ose për regjistrime të tjera të detyrueshme brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e themelimit ose nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose hartimit të aktit të detyrueshëm për t'u regjistruar.

Neni 9

Rregullat e emërtimit

1. Ndalohet regjistrimi në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse i organizatave me emra të njëjtë ose të ngjashëm, me emra në trajtën e shquar apo shkurtimet përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra që janë në kundërshtim me rendin ose me dispozitat urdhëruese të ligjit.

2. E drejta për të regjistruar emrin njihet në bazë të parimit të përparësisë së paraqitjes së kërkesës për regjistrim në gjykatë.

Neni 10

Personat e autorizuar për të bërë regjistrimin

1. Kërkesa për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse mund të paraqitet bashkërisht nga të gjithë themeluesit ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. Kërkesa për regjistrimet e tjera paraqitet nga organi ekzekutiv që ka të drejtën e përfaqësimit të organizatës me të tretët ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.

2. Kërkesa për regjistrim fillestar dhe regjistrimet e tjera të organizatave jofitimprurëse të huaja bëhet nga përfaqësuesi ligjor i degës ose i organizatës jofitimprurëse të huaj ose nga çdo person i autorizuar nga njëri prej personave të përmendur më sipër.

3. Në çdo rast, të drejtën për të kërkuar regjistrimin fillestar ose regjistrimet e tjera e ka edhe çdo person tjetër që ligji i posaçëm ia ka njohur këtë të drejtë.

Neni 11

Kërkesa për regjistrim dhe forma e dokumenteve shoqëruese

1. Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër kryhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për regjistrim, sipas formularit përkatës, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në formë shkresore ose në formë elektronike. Kërkesës për regjistrim i bashkëlidhen dokumentet shoqëruese që provojnë të dhënat që regjistrohen.

2. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dhe të jenë hartuar sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga legjislacioni përkatës ose nga dispozitat e këtij ligji. Dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen edhe në format elektronik, sipas parashikimeve të kreut V të këtij ligji.

3. Dokumentet shoqëruese nuk duhet të përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse ligjore, dhe përmbajtja e tyre duhet të duket qartë, të jetë e lexueshme dhe të lejojë marrjen e imazhit elektronik të dokumentit.

4. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Kërkuesi, së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Shkresat private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

SEKSIONI III

REGJISTRIMI FILLESTAR

Neni 12

Aktet për regjistrimin fillestar

1. Organizatat jofitimprurëse regjistrohen në regjistrin elektronik duke depozituar kërkesën për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, aktet e emërimit të organeve vendimmarrëse, duke përfshirë edhe aktin për caktimin e përfaqësuesit ligjor të organizatës jofitimprurëse, nëse nuk përfshihet në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin sipas legjislacionit në fuqi.

2. Për fondacionet që themelohen në bazë të një akti testamentar, bashkë me kërkesën për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, depozitohet testamenti dhe statuti në rastet kur është hartuar dhe miratuar nga ekzekutori i testamentit.

3. Degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, përveç përmbushjes së kërkesave të tjera të legjislacionit në fuqi, regjistrohen duke depozituar kërkesën për regjistrim fillestar të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, si dhe:

a) aktin e themelimit e statutin e organizatës jofitimprurëse të huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta ose, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme;

b) dokumentacionin që vërteton regjistrimin e organizatës jofitimprurëse të huaj në juridiksionin e huaj;

c) dokumentacionin që vërteton gjendjen aktuale të organizatës jofitimprurëse të huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;

ç) vendimin ose aktet e tjera të organit kompetent të organizatës jofitimprurëse të huaj sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës në Shqipëri.

Neni 13

Organizatat jofitimprurëse me themelues të huaj

Në rastet e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse me themelues një person juridik të huaj, përveç dokumenteve të kërkuara sipas formës së organizatës jofitimprurëse, kërkesës për regjistrim fillestar i bashkëlidhen edhe dokumentet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji për personin juridik të huaj.

Neni 14

Të dhënat e detyrueshme për organizatat jofitimprurëse

Për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) emri;
- b) forma e organizimit;
- c) data e themelimit;
- ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen, datëlindjen, adresën e vendbanimit, numrin e identitetit, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre. Në rastet kur themeluesi është person juridik, të dhënat e detyrueshme për t'u regjistruar janë emri i personit juridik, forma juridike, numri unik i identifikimit, data e themelimit dhe e regjistrimit, selia, emri i përfaqësuesit ligjor të subjektit apo personave përgjegjës për përfaqësimin e subjektit në marrëdhënie me të tretët, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre;
- d) selia;
- dh) qëllimi dhe fusha e veprimtarisë;
- e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- ë) anëtarët e organeve drejtuese, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen, datëlindjen e tyre, numrin e identitetit, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre;
- f) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e organizatës jofitimprurëse në marrëdhënie me të tretët, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen, datëlindjen, adresën e vendbanimit, numrin e identitetit dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre;
- g) përbërja dhe vlera pasurore e fondit themelues në rastin e fondacionit;
- gj) specimetet e nënshkrimit (firmave) të personave që përfaqësojnë organizatën jofitimprurëse përpara të tretëve.

Neni 15

Të dhënat e detyrueshme për degët e organizatave jofitimprurëse të huaja

Për regjistrimin fillestar të degëve të organizatave jofitimprurëse të huaja janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e”, “ë” “f” dhe “g” të nenit 14 të këtij ligji për organizatat jofitimprurëse të huaja, përfshirë numrin dhe vendin e regjistrimit;
- b) emri i degës, nëse është i ndryshëm nga ai i organizatës jofitimprurëse të huaj;
- c) kohëzgjatja e degës, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
- ç) qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së degës;
- d) selia e degës;

dh) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës në marrëdhënie me të tretët, përfshirë edhe aktin për caktimin ose emërimin e përfaqësuesit ligjor të degës së organizatës së huaj, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;

e) specimet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën në marrëdhënie me të tretët.

Neni 16

Pasojat e regjistrimit fillestar

Organizatave jofitimprurëse fitojnë personalitet juridik ditën që vendimi i gjykatës për regjistrimin e saj ka marrë formë të prerë. Me fitimin e personalitetit juridik, organizatat jofitimprurëse regjistrohen nga sekretaria e regjistrimit elektronik në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse.

SEKSIONI IV

REGJISTRIMET E TJERA

Neni 17

Regjistrimet e tjera të detyrueshme

1. Çdo organizatë jofitimprurëse që kryen regjistrimin fillestar mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese që depozitohen në regjistrin elektronik, sipas seksionit III të kreut II të këtij ligji.

2. Në rast ndryshimi të aktit të themelimit ose statutit, depozitohet edhe teksti i plotë i tyre, që pasqyron ndryshimet e mëpasshme. Për degët e organizatave jofitimprurëse të huaja depozitohet statuti dhe akti i themelimit i organizatës jofitimprurëse të huaj ose dokumenti ekuivalent i krijimit, sipas legjislacionit të huaj, me tekstin e plotë që pasqyron ndryshimet e bëra.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, organizatat jofitimprurëse duhet të regjistrojnë dhe të depozitojnë aktet përkatëse si më poshtë:

a) pasqyrat financiare vjetore të mbajtura sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;

b) emërimin e likuidatorit, si dhe të dhënat e tij të identifikimit;

c) aktet e prishjes, të mbylljes ose të shpërndarjes, aktet e transformimit, të bashkimit, të ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për degët e organizatave jofitimprurëse të huaja regjistrohen edhe aktet e transformimit, të bashkimit, të ndarjes, të hapjes dhe të mbylljes së procedurave të likuidimit ose të falimentimit të organizatës jofitimprurëse të huaj;

ç) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

d) kompetencat e përfaqësimit të organeve drejtuese ose të likuiduesve;

dh) emri, mbiemri, datëlindja dhe vlera e kontributeve pasurore të fondit themelues (nëse ka të tilla);

e) çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 18

Regjistrimet e tjera vullnetare

Organizatave jofitimprurëse kanë të drejtë që me kërkesën e tyre të regjistrojnë në regjistrin elektronik çdo të dhënë tjetër, të ndryshme nga të dhënat e përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna shtesë përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) emërtimin ose shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë (nëse është i/janë të ndryshëm nga emri i regjistruar i organizatës jofitimprurëse);

b) faqen e internetit, adresën e-mailit, numrin e telefonit dhe faksit;

c) vendimet e organeve drejtuese të organizatës jofitimprurëse si vendimet e pezullimit të veprimtarisë ose vendimet e tjera të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim;

ç) të dhëna të tjera të lidhura me veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse.

Neni 19

Regjistrimet me vendim gjyqësor

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistron në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse dhe publikon, kryesisht ose me kërkesë nga çdo person i interesuar, vendimet gjyqësore për të dhënat e regjistruara ose veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse.

2. Kërkesës për regjistrim nga personat e interesuar i bashkëlidhet vendimi përkatës. Regjistrimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji.

SEKSIONI V

ÇREGJISTRIMI

Neni 20

Çregjistrimi i subjektit

1. Organizatat jofitimprurëse çregjistrohen nga regjistri elektronik në rastet e parashikuara nga ligji që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, në rastet kur ligji parashikon prishjen dhe pavlefshmërinë e personave juridikë, si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

2. Çregjistrimi kryhet:

a) në mënyrë vullnetare me iniciativën e vetë organizatës jofitimprurëse;

b) në bazë të një vendimi gjyqësor;

c) sipas parashikimit të ligjeve të posaçme.

Neni 21

Çregjistrimi vullnetar

Kur vendoset shpërndarja nga vetë organizata jofitimprurëse, çregjistrimi nga regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse kryhet vetëm pasi vendimi i gjykatës për çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse ka marrë formë të prerë.

Neni 22

Çregjistrimi me vendim gjyqësor

Në rastet kur gjykata vendos shpërndarjen e organizatës jofitimprurëse, çregjistrimi nga regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse kryhet vetëm pasi vendimi i gjykatës për çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse ka marrë formë të prerë.

Neni 23

Të dhënat e subjekteve të çregjistruara

1. Të dhënat e organizatave jofitimprurëse të çregjistruara mbahen në regjistrin elektronik duke vënë shënimin “i çregjistruar”, si dhe numrin e datën e vendimit gjyqësor që ka vendosur çregjistrimin nga regjistri sipas ligjeve të posaçme. Këto të dhëna ruhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në format elektronik dhe janë gjithnjë të aksesueshme për publikun.

2. Emri i organizatës jofitimprurëse ndalohet të përdoret dhe nuk mund të regjistrohet nga asnjë subjekt tjetër për një afat prej 6 (gjashtë) muajsh nga data e çregjistrimit.

Neni 24

Pasojat e çregjistrimit

1. Çregjistrimi i organizatave jofitimprurëse nga regjistri elektronik ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik të subjekteve.

2. Çregjistrimi nga regjistri i organizatave jofitimprurëse i degëve të organizatave jofitimprurëse të huaja, që nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit, ka vetëm efekt deklarativ.

KREU III
ORGANET PËRGJEGJËSE PËR REGJISTRIMIN

SEKSIONI I

SHQYRTIMI DHE VENDIMMARRJA

Neni 25

Gjyqtari i vetëm

Vendimi për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse, si dhe vendimi për çregjistrimin e tyre merret nga një gjyqtar i seksionit tregtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 26

Kancelari

Vendimi për regjistrimet e tjera, sipas përcaktimit të seksionit IV të kreut II të këtij ligji, merret nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 27

Sekretaria e regjistrimit elektronik

1. Sekretaria e regjistrimit elektronik është struktura përgjegjëse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për administrimin e regjistrimit elektronik në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Sekretaria e regjistrimit drejtohet nga kryesekretari, i cili është përgjegjës për mbajtjen e korrespondencave të sekretarisë së regjistrimit me palët e treta dhe për koordinimin e punës brenda kësaj zyre.

2. Sekretaria e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse është përgjegjëse dhe kryen këto funksione:

a) administron procedurën e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, ndryshimeve në aktin e themelimit dhe statutin e organizatave jofitimprurëse dhe kryen shënimet përkatëse në skedën elektronike të secilës organizatë;

b) administron vendimet e lëshuara për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse, depozitimin e akteve të organizatave jofitimprurëse, si edhe çregjistrimin e tyre;

c) lëshon ose miraton lëshimin e vërtetimeve të regjistrimit, vërtetimeve historike të akteve në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, si dhe vërtetimeve të tjera në rastet e parashikuara me ligj dhe është përgjegjëse për nënshkrimin e tyre sipas ligjit;

ç) lëshon kopje të njësuara me origjinalin të akteve që ndodhen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse e i vërteton ato dhe është përgjegjëse për nënshkrimin e tyre sipas ligjit;

d) përditëson dhe kontrollon regjistrin me listën e personave të shpallur sipas legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit. Në rastet kur konstatohet se një nga individët, pjesë e organeve drejtuese, vendimmarrëse, themeluese apo në funksionin e përfaqësuesit ligjor, rezulton në listën e personave të shpallur, sekretaria e regjistrit elektronik njofton autoritetin kompetent shtetëror për marrjen e masave në përputhje me legjislacionin në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit.

3. Veprimet për regjistrimin, depozitimin, lëshimin e vërtetimeve, të kopjeve të tyre dhe të akteve që mbahen në regjistrin elektronik autorizohen nga sekretaria e regjistrit elektronik kundrejt pagesës së tarifave të shërbimit. Tarifat e shërbimit përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për tarifat gjyqësore.

Neni 28

Paraqitja e kërkesave

1. Kërkesa për regjistrim paraqitet në formë shkresore ose elektronike në sekretarinë e regjistrit elektronik.

2. Sekretaria e regjistrit elektronik udhëzon kërkuesin për plotësimin e kërkesës dhe kryen verifikimet e mëposhtme:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të kërkuar regjistrimin;

b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;

c) paraqitjen në formën e kërkuar të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;

ç) faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë në mënyrë të dukshme të dhënat që përmbajnë dokumentet që shoqërojnë formularin;

d) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik;

dh) nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet;

e) pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim;

ë) nëse individë, pjesë të themeluesve apo organeve drejtuese të organizatës jofitimprurëse, janë në listën e personave të shpallur sipas legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit.

3. Sekretaria e regjistrit elektronik lëshon një konfirmim sipas një formati të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për çdo kërkesë të dorëzuar. Konfirmimi duhet të tregojë kohën e dorëzimit, numrin rendor të paraqitjes së kërkesës, objektin e kërkesës, listën e dokumenteve të dorëzuara dhe shumën e tarifës së paguar.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë merr në shqyrtim kërkesat për regjistrim sipas radhës së paraqitjes së tyre.

5. Sekretaria e regjistrit është e detyruar të marrë në dorëzim çdo kërkesë të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse kërkesa është e paplotë ose dokumentet shoqëruese janë të pasakta.

6. Regjistrimi, përpunimi, shqyrtimi i kërkesave nga gjyqtari ose nga kancelari, si dhe ruajtja e të dhënave të njoftuara dhe të depozituara në regjistër kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar.

Neni 29

Pezullimi i shqyrtimit të kërkesës

1. Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit apo nuk janë kryer veprimet e kërkuara sipas nenit 46 të këtij ligji, gjyqtari ose kancelari, sipas rastit, pezullon shqyrtimin e kërkesës dhe e njofton kërkuuesin me shkrim për shkakun e pezullimit, duke i dhënë një afat deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për plotësimin ose ndreqjen e të metave që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

2. Nëse kërkuesi plotëson ose ndreq të metat që pengojnë regjistrimin brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh pune nga data e plotësimit ose ndreqjes së dokumentacionit. Në këtë rast, regjistrimi mban datën e paraqitjes së kërkesës së parë për regjistrim.

Neni 30

Përfundimi i gjyqtarit ose kancelarit

1. Gjyqtari ose kancelari është i detyruar të heqë dorë nga shqyrtimi i kërkesës për regjistrim në rastet e parashikuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile.

2. Për heqjen dorë dhe përfundimin e gjyqtarit ose të kancelarit nga shqyrtimi i kërkesës zbatohen nenet 73, 74 dhe 75 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Në rastet kur kryetari i gjykatës ka pranuar heqjen dorë të kancelarit ose kancelari është përfunduar nga shqyrtimi i një kërkesë për regjistrim sipas neneve 74 dhe 75 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi për regjistrimet e tjera, sipas përcaktimit të seksionit IV të kreut II të këtij ligji, merret nga një gjyqtar i seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 31

Vendimi i gjyqtarit

1. Gjyqtari, me përfundim të rasteve kur ka pezulluar shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 29 të këtij ligji, vendos për kërkesat e regjistrimit ose të çregjistrimit në dhomë këshillimi brenda

15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në sekretarinë e regjistrit ose në formë elektronike.

2. Vendimi për regjistrimin jepet nga gjyqtari edhe në rastin kur një gjykatë tjetër ka marrë vendim për kryerjen e këtij veprimi.

Neni 32

Vendimi i kancelarit

Kancelari, me përjashtim të rasteve kur ka pezulluar shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 29 të këtij ligji, vendos për kërkesat për regjistrimet e tjera sipas përcaktimit të seksionit IV të kreut II të këtij ligji brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës në sekretarinë e regjistrit elektronik ose në formë elektronike.

Neni 33

Mospranimi i kërkesës për regjistrim

1. Mospranimi i kërkesës për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse në regjistrin elektronik bëhet me vendim të gjyqtarit të seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Mospranimi i kërkesës për regjistrimet e tjera, sipas përcaktimit të seksionit IV të kreut II të këtij ligji, bëhet me vendim të kancelarit.

3. Kërkesa për regjistrim refuzohet vetëm në rastet kur:

a) kërkesa nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj ose në ligjin për organizatat jofitimprurëse dhe kërkuesi nuk plotëson ose ndreq të metat që pengojnë regjistrimin brenda afatit;

b) të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të këtij ligji ose të ligjit për organizatat jofitimprurëse;

c) individë, pjesë e themeluesve ose organeve drejtuese apo vendimmarrëse të organizatës jofitimprurëse, janë në listën e personave të shpallur sipas legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit.

4. Vendimi i refuzimit i njoftohet kërkuesit me shkrim sipas formularit standard në të cilin jepet edhe shkaku i këtij refuzimi.

5. Kundër vendimit të gjyqtarit për mospranimin e kërkesës për regjistrim fillestar mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Tiranës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga njoftimi i vendimit.

6. Kundër vendimit të kancelarit për mospranimin e kërkesës për regjistrimet e tjera mund të bëhet ankim pranë gjyqtarit të seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga njoftimi i vendimit. Në këtë rast, gjyqtari shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 5 (pesë) ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Ndaj vendimit të gjyqtarit për mospranimin e ankimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Neni 34

Përmbajtja e vendimit të regjistrimit

Vendimi i gjyqtarit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse ose i kancelarit për regjistrimin e të dhënave të tjera duhet të përmbajë në mënyrë të plotë çështjet që duhet të pasqyrohen në regjistrin elektronik.

Neni 35

Ekzekutimi i vendimit të regjistrimit

1. Vendimi i gjyqtarit për regjistrimin ose çregjistrimin në regjistrin elektronik, si dhe vendimi i kancelarit për regjistrimet e tjera regjistrohen në regjistrin elektronik nga sekretaria e regjistrit ditën që vendimi ka marrë formë të prerë.

2. Menjëherë me regjistrimin e vendimit, sekretaria e regjistrit lëshon certifikatën e regjistrimit ose vërtetimin e kryerjes së regjistrimeve të tjera.

SEKSIONI II

REGJISTRIMI I NJËKOHSHËM, NUMRI UNIK I IDENTIFIKIMIT, PUBLIKIMI DHE LËSHIMI I CERTIFIKATAVE

Neni 36

Regjistrimi i njëkohshëm

1. Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse në regjistrin elektronik përbën gjithashtu regjistrimin e njëkohshëm të tyre pranë administratës tatimore qendrore dhe vendore në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pranë inspektoratit të punës.

2. Organizatat jofitimprurëse, për qëllimet e regjistrimit e të pajisjes me certifikatën e regjistrimit fillestar, deklarojnë gjithashtu të dhënat e detyrueshme sipas legjislacionit tatimor, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave sipas formularëve përkatës.

3. Me përjashtim të rasteve kur ligji shprehimisht kushtëzon nisjen e veprimtarisë përkatëse me marrjen e një lejeje, licence apo autorizimi, organizata jofitimprurëse e pajisur nga sekretaria e regjistrit me certifikatën e regjistrimit fillestar ka të drejtë të nisë menjëherë veprimtarinë e saj.

Neni 37

Numri unik i identifikimit të subjektit

1. Me regjistrimin në regjistrin elektronik, organizatave jofitimprurëse u jepet numri i identifikimit, i cili gjenerohet në mënyrë elektronike nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është unik për çdo organizatë jofitimprurëse të regjistruar.

2. Numri unik i identifikimit të organizatës jofitimprurëse është i vlefshëm për identifikimin e organizatave për qëllimet e regjistrimit në regjistrin elektronik, për qëllimet e regjistrimit si

person i tatueshëm pranë autoriteteve tatimore qendrore dhe vendore, për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës, si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues.

3. Numri unik i identifikimit të organizatave jepet vetëm një herë në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet organizatave të tjera edhe pas çregjistrimit.

Neni 38

Publikimi elektronik

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë publikon në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet nga sekretaria e regjistrimit, në format elektronik dhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çdo rast të regjistrimit ose të ndryshimit të të dhënave në regjistër të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin;
- b) formën e organizimit;
- c) datën e themelimit;
- ç) qëllimin dhe fushën e veprimtarisë;
- d) kohëzgjatjen, në qoftë se është e përcaktuar;
- dh) emrin e përfaqësuesit ligjor;
- e) numrin unik të identifikimit.

2. Sekretaria e regjistrimit elektronik kryen publikimin në buletin brenda 1 (një) dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qartë data në të cilën është regjistruar e dhëna e publikuar.

3. Publikimi në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit përbën publikim zyrtar të regjistrimeve, të kryera në kuptim të nenit 7 të këtij ligji.

4. Publikimi i të dhënave sipas këtij neni kryhet në përputhje me kufizimet e vendosura nga legjislati në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 39

Certifikata e regjistrimit fillestar

1. Sekretaria e regjistrimit elektronik, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj për regjistrimin fillestar, i lëshon organizatës jofitimprurëse të regjistruar certifikatën e regjistrimit, e cila përmban emrin, formën, numrin unik të identifikimit, numrin serial të certifikatës, datën e regjistrimit fillestar dhe selinë ose adresën e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë.

2. Në rast se organizata jofitimprurëse e regjistruar ushtron veprimtarinë në më shumë se një vend, sekretaria e regjistrimit elektronik lëshon nga një certifikatë regjistrimi për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë gjithashtu emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar, numrin serial të certifikatës, si dhe të njëjtin numër unik të identifikimit të organizatës jofitimprurëse.

3. Në rastet kur organizata jofitimprurëse ndryshon emrin, formën, selinë ose vendet e ushtrimit të veprimtarisë, sekretaria e regjistrimit elektronik zëvendëson certifikatat e lëshuara më parë me një certifikatë të re për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Këto certifikata, përveç

adresës përkatëse, përmbajnë gjithashtu emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe numrin unik të identifikimit të organizatës jofitimprurëse.

4. Certifikata e regjistrimit lëshohet në një kopje origjinale për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Në rast humbjeje apo dëmtimi të certifikatës së regjistrimit, ajo zëvendësohet me një dublikatë të lëshuar nga sekretaria e regjistrimit elektronik.

5. Organizata jofitimprurëse është e detyruar të vendosë certifikatën përkatëse në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë, në një vend të dukshëm.

Neni 40

Vërtetime për regjistrimet

Pas regjistrimit, sipas dispozitave të këtij ligji, sekretaria e regjistrimit elektronik i lëshon subjektit një vërtetim regjistrimi, ku përcaktohen qartë veprimi i kryer dhe data e këtij regjistrimi.

Neni 41

Formati dhe përmbajtja

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me propozimin e kancelarit, miraton formatin dhe përmbajtjen e certifikatave të vërtetimeve dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit sipas këtij ligji.

Neni 42

Korrigjimi i gabimeve

1. Gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësitë e tjera të dukshme, të bëra gjatë regjistrimeve, të cilat rezultojnë qartë nga dokumentacioni i depozituar dhe nuk cenojnë vlefshmërinë e regjistrimit, mund të korrigjohen nga sekretaria e regjistrimit elektronik, kryesisht apo me kërkesë të personave të interesuar.

2. Ndryshimi i të dhënave të pasakta, të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një kërkesë të re për regjistrim.

3. Ndrejja e pasaktësive apo gabimeve publikohet sipas dispozitave të nenit 38 të këtij ligji.

4. Kërkesa për ndrejje të gabimeve kryhet pa pagesë.

KREU IV

AKSESI PUBLIK DHE EKSTRAKTET

Neni 43

Publikimi i të dhënave

1. Çdo person i interesuar mund të kryejë sipas këtij ligji pa pagesë kërkime në regjistrin elektronik për çdo të dhënë të regjistruar, në përputhje me kufizimet e vendosura nga legjislati në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Publikimi i të dhënave në regjistrin elektronik bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligji në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 44

Ekstraktet e regjistrit elektronik

1. Sekretaria e regjistrit elektronik konfirmon të dhënat e regjistruara nga organizatat jofitimprurëse nëpërmjet lëshimit të ekstrakteve në format shkresor apo elektronik sipas këtij ligji. Çdo person, në rast se kërkon informacion në format shkresor për të dhënat e regjistruara të çdo organizate jofitimprurëse, si dhe kopje të dokumenteve shoqëruese të depozituara në regjistër, ka të drejtë t'i marrë ato pa pengesa nga sekretaria e regjistrit elektronik kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, e cila është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe kur është rasti e dërgimit të tij.

2. Ekstraktet mund të lëshohen për të dhëna të caktuara të organizatave jofitimprurëse, si dhe për historikun e veprimeve të kryera nga një organizatë jofitimprurëse.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me propozimin e kancelarit, miraton formatin e ekstrakteve dhe të kërkesës për lëshimin tyre.

Neni 45

Vërtetimi i ekstrakteve dhe i dokumenteve shoqëruese

1. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese në format shkresor si rregull lëshohen nga sekretaria e regjistrit elektronik, si kopje e vërtetuar e të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse, përveç rastit kur personi i interesuar heq dorë nga marrja e këtij vërtetimi.

2. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese në format elektronik si rregull lëshohen nga sekretaria e regjistrit elektronik si kopje e pavërtetuar e të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse, përveç rastit kur personi i interesuar shprehimisht kërkon ta marrë këtë vërtetim.

KREU V

SPORTELI ELEKTRONIK

Neni 46

Veprimet pranë sportelit elektronik

1. Çdo shtetas, pasi të jetë identifikuar elektronikisht, ka të drejtë që në cilësinë e kërkuesit ose të personit të autorizuar të paraqesë një kërkesë për regjistrim apo të kryejë pranë sportelit elektronik çdo regjistrim ose veprim tjetër sipas këtij ligji, përfshirë këtu procedurën e ankimit

ndaj vendimit të kancelarit, sipas nenit 33 të këtij ligji, dhe të marrë nga sekretaria e regjistrit elektronik nëpërmjet këtij sporteli të gjitha aktet përkatëse të parashikuara nga ky ligj.

2. Nëpërmjet sportelit elektronik mund të kryhen kërkime elektronike në regjister, të merren ekstrakte, si dhe kopje të dokumenteve shoqëruese në format elektronik ose të kryhen veprime të tjera për të cilat identifikimi i personit ose kryerja e pagesës së një tarife nëpërmjet mjeteve elektronike nuk kërkohet sipas këtij ligji.

Neni 47

Identifikimi elektronik

Veprimet pranë sportelit elektronik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilat ky ligj kërkon identifikimin elektronik, kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

Neni 48

Kushtet procedurale dhe teknike

Këshilli i Ministrave përcakton kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve nga sekretaria e regjistrit elektronik, sipas këtij ligji, nëpërmjet portalit e-albania, kushtet dhe mënyrat e pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik, procedurat për ndryshimin e tyre, kushtet e sigurisë dhe të ruajtjes së komunikimeve elektronike, mënyrat e vërtetimit të dokumenteve elektronike të lëshuara nga sekretaria e regjistrit elektronik, kërkesat dhe teknologjinë e zbatueshme për realizimin e tyre sipas këtij kreu, si dhe procedurat e njoftimit publike të realizuara nga sekretaria e regjistrit elektronik.

KREU VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 49

Kundërvajtjet administrative

1. Organizata jofitimprurëse, si dhe personat e autorizuar për të bërë regjistrimin janë përgjegjëse sipas ligjeve në fuqi për vërtetësinë e fakteve, të të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese të depozituara në regjistrin elektronik.

2. Deklarimi në regjistrin elektronik i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 0.1% deri në 1% të të ardhurave vjetore të deklaruara nga organizata jofitimprurëse.

3. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 0.1% deri në 1% të të ardhurave vjetore të deklaruara nga organizata jofitimprurëse.

4. Në çdo rast, masa e gjobës, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, nuk mund të jetë më e vogël se 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

5. Në rast se kancelari, kryesisht, konstaton që organizata jofitimprurëse ka deklaruar të dhëna të pavërteta ose nuk ka përmbushur detyrimet për regjistrim fillestar, apo regjistrime të tjera të detyrueshme, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, përpara marrjes së vendimit, njofton palët për paraqitjen e kërkesës për regjistrim ose korrigjimin e të dhënave. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, organizata jofitimprurëse, si dhe personat e autorizuar nuk paraqesin kërkesën, kancelari vendos gjobë sipas përcaktimeve të neneve 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

6. Gjoha vendoset nga kancelari sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative. Vendimi i kancelarit për dënimin me gjobë ankimohet drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 50

Regjimi tranzitor

1. Deri në fillimin e funksionimit të regjistrit elektronik, procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse kryhen sipas parashikimeve të ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

2. Administrata tatimore brenda 3 (tre) muajve nga krijimi i regjistrit elektronik i jep Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjitha të dhënat që disponon për organizatat jofitimprurëse të regjistruara pranë tyre.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 6 (gjashtë) muajve nga krijimi i regjistrit elektronik përditëson regjistrin elektronik me të dhënat e nevojshme dhe njofton të gjitha organizatat jofitimprurëse të regjistruara në regjistër për plotësimin e dokumentacionit, nëse konstatohet se dokumentacioni i administruar kërkon përditësim në përmbushje të detyrimeve për regjistrim sipas këtij ligji.

4. Organizatat jofitimprurëse kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në plotësimin e të dhënave të nevojshme, në përmbushje të kërkesave të këtij ligji, për regjistrimin fillestar.

5. Organizatat jofitimprurëse, që nuk janë të regjistruara në administratën tatimore, si dhe nuk kërkojnë regjistrimin në administratën tatimore brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çregjistrohen nga regjistri i organizatave jofitimprurëse.

Neni 51

Ndryshime

Në ligjin nr. 8789, datë 7.5.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në nenin 22, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Regjistrimi dhe çregjistrimi i organizatave jofitimprurëse, si dhe depozitimi i akteve të tjera të tyre në regjistër për ndryshime në aktin e themelimit apo statut, për transformimin, bashkimin, ndërprerjen e veprimtarisë apo shpërndarjen, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, bëhet me kërkesë të subjektit të interesuar, e cila depozitohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e vendimit të organit kompetent të organizatës jofitimprurëse për këto ngjarje.”

2. Pas nenit 39 shtohet kreu VII/1 me këtë përmbajtje:

“KREU VII/1

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 39/1

Kundërvajtjet administrative

1. Mospërmbushja e detyrimit për regjistrimin ose çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse dhe depozitimin e akteve të tjera në regjistër brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, dënohet nga gjykata me gjobë nga 0.1% deri në 1% të të ardhurave vjetore të deklaruara nga organizata jofitimprurëse.

2. Në çdo rast, masa e gjobës, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mund të jetë më e vogël se 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

3. Kundër vendimit për dënimin me gjobë mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit.”.

Neni 52

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 2, dhe 48 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Lartë Gjyqësor që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë formularët dhe formatet sipas parashikimit të neneve 6, pika 2; 28, pika 3; 29, pika 1; 41 dhe 44, pika 3, të këtij ligji.

3. Data e fillimit të funksionimit të regjistrimit elektronik caktohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor pas marrjes së mendimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, jo më vonë se data 30 gusht 2021.

Neni 53

Shfuqizime

Në datën e fillimit të funksionimit të regjistrimit elektronik, ligji nr. 8789, datë 7.5.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” dhe aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 54

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç sa është parashikuar në pikën 2 të këtij neni.
2. Neni 51 i këtij ligji hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 24.6.2021